

# KULTURA 2023



Nr.18

BULETINI MUJOR / QERSHOR

kultura.gov.al



## FESTIVALI FOLKLORIK KOMBËTAR I GJIROKASTRËS, NË 8 DITË BËRI BASHKË GJITHË SHQIPTARËT

U përmbyll në mënyrë madhështore edicioni XI i Festivalit Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës. Nga data 24 qershor, deri në 1 korrik 2023 u zhvillua një nga ngjarjet më të mëdha dedikuar folklorit shqiptar. Një aktivitet i shumë pritur, i cili u rikthye pas 8 vitesh mungese. Në 8 ditë aktivitet, të konceptuar si një festë u ngjiten në skenën e kalasë dhe atë të Sheshit të Çerçizit mbi 1200 interpretues profesionistë e amatorë nga Shqipëria, Kosova e diaspora. Interpretuesve nga 12 qarqe të vendit iu bashkuan të ftuar nga Maqedonia e Veriut, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zvicra, Britania e Madhe, Italia, Mali i zi e Greqia. Në ceremoninë e hapjes, Ministria e Kulturës Elva Margariti premtoi se ky edicion është hapi i parë i dokumentimit dhe krijimit të një dosjeje kandidimi që ky festival të futet nën mbrojtjen e UNESCO-s, ashtu si ndodhi me dihebërjen e xhubletës dhe si pritet të ndodhë me Kcimin e Tropojës, këngët me lahutë dhe shtegëtimi i bagëtive.

**NË 8 DITË AKTIVITET, TË KONCEPTUAR SI NJË FESTË U NGJITËN NË SKENËN E KALASË DHE ATË TË SHESHIT TË ÇERÇIZIT MBI 1200 INTERPRETUES PROFESIONISTË E AMATORË NGA SHQIPËRIA, KOSOVA E DIASPORA**

Në skenën e festivalit, me një skenografi ideuar nga Ina Lisi në bashkëpunim me artisten spanjole Ines Esnal, realizuar nga një staf prej 15 vetësh, që thurën 20 kilometra fije, si një tribut për artizanët shqiptar u ngjiten këngë, valle, rite dhe kostume nga çdo trevë shqipfolëse. Rreth 80 aktivitete paralele gjalluan çdo rrugicë të kalldrëmtë duke demonstruar traditat më të mira në artizanat e kulinari, valle e këngë, që tërhoqën vëmendjen e një numri shumë të lartë vizitorësh shqiptarë e të huaj, që tejmbushën qytetin e gurtë. Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës 2023 u rikthye nën organizimin e Ministrisë së Kulturës, nën drejtimin artistik të prof. Thoma Gaqi, drejtimin organizativ të Genci Bejlerit, regji të Bledi Laços, konceptin vizual të Eri Kukes dhe një grupi të madh ekspertësh, muzikologësh, që u angazhuan në terren për seleksionimin e materialeve, që u ngjiten në skenë.



## DIRIGJENTI LEGJENDAR ZUBIN MEHTA JEP KONCERT NË TIRANË

Zubin Mehta, legjenda e dirigjimit botëror u ngjiti në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit në datën 22 qershor 2023. Dy gjeneratë kompozicionit Beethoven dhe Berlioz erdhën në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, nën interpretimin virtuoz të Orkestrës Filarmonike të Beogradit, që feston 100-vjetorin e krijimit. Pas koncertit në Beograd mjeshtri 87-vjeçar, Zubin Mehta udhëtoi drejt Tiranës e më pas në Shkup. Ardhja e Zubin Mehtës në Tiranë, këtij ambasadori të kulturës dhe paqes në botë ishte jo vetëm një ngjarje madhe kulturore, që u dëshmuar nga duartrokitjet e gjata të publikut, por edhe një konfirmim që kryeqyteti ynë është futur në agjendat e yjeve botërore.



## SHPALLEN 6 FITUESIT E FONDIT TË PËRKTHIMIT NË GJUHË TË HUAJ

Mes 24 aplikimeve shpallen u shpallën 6 fituesit e Fondit të Përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhën e huaj. Fatos Lubonja (polonisht), Luljeta Lleshanaku (greqisht), Arjan Leka (maqedonisht), Enkelejd Lamaj (italisht), Diana Çuli (arabisht), Andreas Dushi (italisht) janë autorët fitues. Si çdo vit, Ministria e Kulturës përmes Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit ndau fituesit e Fondit të përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhën e huaj, që synon promovimin e letërsisë shqipe përtej kufijve. Këtë vit u numëruan 24 aplikime, për përkthime në gjuhë të ndryshme, që nga italishtja e greqishtja, deri në arabisht. Edhe pse kriteret e përzgjedhjes janë shumë profesionale, që i referohen cilësisë së përkthimit, mes fituesve janë breza të ndryshëm autorësh, nga ata të afirmuarit te më të rinjtë.

## SHPALLET FITUESI, "OPPENHEIM ARCHITECTURE" DO TË PROJEKTOJË MUZEUN "BESA"

"Oppenheim Architecture" është studioja fituese e konkursit ndërkombëtar për projektin e muzeut "Besa", që do të ngrihet në Tiranë, në ish-shtëpinë e Libohovitëve. Mënyra e fuqishme se si komunikon mesazhin dhe tregon historinë e Besës, i jep asaj një identitet dhe frymëzton vizitorët që të përqafojnë vlerat e saj; ndërhyrja minimaliste arkitekturore, që nxjerr në pah vlerat e ndërtesës si pjesë e trashëgimisë, e trajtuar me respekt dhe ndjeshmëri, koncepti i zhvilluar mirë si muze dhe qendër kulturore; harmonia e funksioneve me kontekstin përreth, e shpallën fituese mes 5 finalistëve studion zvicerane. Prezantimi publik i 5 projektideve finaliste u zhvillua në datën 26 qershor 20223.

Kandidatët ishin:

- "EAA" (Emre Arolat Architecture)
- "Oppenheim Architecture"
- "Schneider" & Schumacher
- "COOK HAFNER ARCHITECTURE PLATFORM AS" & "ARCHISPACE" SHPK
- "MVRDV B.V 5283357" & "I Ri" ltd L71726018M & OVE Arup & Partners Ireland Ltd" & "Martha Schëartz Partners" LLC



## JAVËT KULTURORE NDËRKOMBËTARE, MARATONË AKTIVITETESH

Javët e Kulturave Ndërkombëtare kanë vijuar me Italinë, Hollandën, Francën e Spanjën, duke sjellë një atmosferë të jashtëzakonshme kulturore dhe artistike jo vetëm në Tiranë por edhe Shkodër, Vlorë, Korçë etj. Java e Kulturës Italiane solli mbi 60 aktivitete, duke përfshirë koncerte, ekspozita, takime dedikuar modës, arkitekturës, kulinariës etj. Ndër aktivitetet më të ndjekura ishte koncerti i sopranos Anna Pirozzi, ai me muzikë të mjeshtrit të kolonave zanore Ennio Morricone, muzikantit Paolo Fresu, shfaqja e "Les Séings", filmi "Loins des barbares" me regji nga Liri Begeja, për të kulmuar me koncertin e yllit të muzikës botërore Enrique Iglesias në Sheshin "Skënderbej", në datën 30 qershor 2023.

**MBI 60 AKTIVITETE SOLLI JAVA E KULTURËS ITALIANE, DUKE PËRFSHIRË KONCERTE, EKSPOZITA, TAKIME DEDIKUAR MODËS, ARKITEKTURËS, KULINARIËS ETJ**

## "AIDA", KTHIM NË OPERA PAS 16 VITESH, REKORD SHIKUESISH

Pas 16 vjetësh një nga kryeveprat e operistikës botërore, "Aida" u rikthye në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit. Një vepër me regji, skenografi dhe kostumografi nga mjeshtri Franco Zeffirelli dhe që angazhoi rreth 200 artistë. Vepërerdhënë interpretimin e Orkestrës Simfonike nën dirigjimin e Jacopo Sipari di Pescasseroli, korit nën drejtimin Dritan Lumshit, trupës së baletit të TKOB dhe solistëve Eva Golemi, Joana Zhelezcheva, Ivana Hoxha, Silvia Pasini, Amadi Lagha,



Denis Skura, Armando Likaj, Piero Terranova, Bledar Domi, Xhieldo Hyseni, Andi Istrefi, Keldi Ametaj, Dorina Selimaj e Marina Kurti. Opera "Aida" theu çdo rekord shikueshmërie në TKOB, duke bërë bashkë mbi 3500 artdashës nga Shqipëria, Italia, Anglia, Zvicra, Amerika, Franca etj. Kjo vënie do të nisat drejt dkenës së Varnës.